

NGROHTORJA E QYTETIT SH.A. GJAKOVË DISTRICT HEATING J.S.C. GJAKOVA


Adresa: "Behije Dashi", pr Rezinë, Gjakovë, Kosovë
Tel & Fax: +381 (0) 390 328 329
Mob: +383 (0) 46 127 066

Nr. i Biznesit: 811326471
E: info@ngrohtorja.org
www.ngrohtorja.org

Më: 14.04.2023

Nr. 261/1

Raporti Vjetor i Punës të N.P. "Ngrohtorja e Qytetit" Sh. A. Gjakovë për vitin 2022



2023

Përmbajtje

1.1.	Kushtet e referencës	3
1.2.	Përmbledhje e raportit	3
1.3.	Kronologjia e proceseve dhe aktiviteteve për vitin 2022	3
1.4.	Raportimi nga Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv	4
1.5.	Historiku	6
1.6.	Informatat e përgjithshme	6
1.7.	Aktivitetet dhe përformanca e ndërmarrjes	10
1.8.	Spektori i Financave dhe Thesarit	10
1.9.	Spektori i faturimit dhe inkasimit	16
1.10.	Spektori i prokurimit	20
1.11.	Spektori Juridik/Administrativ	22
1.12.	Burimet njerëzore	23
1.13.	Aktivitetet e Auditimit të Brendshëm	23
1.14.	Synimet e ndërmarrjes	24
1.15.	Rekomandime	26

1.1. Kushtet e referencës

Ky raport pasqyron gjendjen reale të kompanisë NP "Ngrohtorja e qytetit" Gjakovë Sh. A.

Qëllimi në përmbajtje të raportit është informimi i Komisionit të Aksionarëve të NP "Ngrohtorja e Qytetit" Gjakova Sh. A. në lidhje me ecurinë e aktiviteteve të zhvilluara gjatë vitit 2022.

1.2. Përmbledhje e raportit

Në kuadër të këtij raporti do të përfshihet një historik i shkurtër i ndërmarrjes, i pasuar me aktivitetet dhe ngjarjet kryesore të zhvilluara gjatë vitit 2022. Ky raport është punuar bazuar në kërkesat ligjore dhe udhëzimit administrative. Gjithashtu përmban edhe informacione tjera, të cilat e bëjnë këtë raport më gjithëpërfshirës për të pasqyruar në mënyrë të qartë punën e ndërmarrjes për periudhën raportuese.

Në fillim të raportit e gjeni Historikun e shkurtër të ndërmarrjes, për të krijuar përshtypjen e përgjithshme për pritshmërinë dhe për të kuptuar më qartë natyrën e punës. Kjo pjesë e raportit ofron të dhëna historike qysh nga themelimi i ndërmarrjes e deri më sot.

Pas historikut do të renditen aktivitetet e bordit të drejtoreve. Pasonjë raportet të cilat përfshijnë aktivitetet e ndërmarrjes duke filluar nga pjesa e prodhimit të energjisë termike, duke vazhduar me aktivitetet në njësinë e shpërndarjes, aktivitetet e prokurimit, aktivitetet e shërbimit juridik, aktivitetet e auditorit të brendshëm, aktivitetet e shërbimit financiar, shërbimit për konsumatorë. Sfidat dhe Rreziqet janë pjesë e këtij raporti. Gjithashtu brenda raportit janë përfshirë edhe aktivitetet e auditimit të brendshëm.

Me qëllim që raporti të jetë sa më i qartë dhe lehtë i kuptueshëm, në të janë inkuadruar edhe tabela si dhe grafikone.

1.3. Kronologjia e proceseve dhe aktiviteteve për vitin 2022

Bordi i drejtoreve i Ngrohtores së Qytetit Sh. A. Gjakovë ka mbajtur 7 (shtatë) takime të rregullta në bazat mujore dhe 1 (një) takim të jashtëzakonshme sipas nevojës ku në secilën mbledhje janë trajtuar pikat e zakonshme si Kurumi, aprovimi i pikave të rendit të ditës dhe procesverbalit paraprak, shqyrtimi dhe miratimi i raporteve të Komisionit të Auditimit dhe Raportit të KE-së.

Gjatë vitit 2022 janë mbajtur 7 mbledhje të BD-ve, dhe 1 (një) mbledhje e jashtëzakonshme ku janë shqyrtuar dhe aprovuar këto vendime :

- Aprovimet e raporteve të KE-së, ZKF-së dhe Sekretares për tremujorin e trete dhe tremujorin e katërt për vitin 2021 edhe raportet vjetore për vitin 2021 me dt: 11.02.2022
- Aprovimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2021 me dt. 11.02.2022.
- Aprovimi i raportit të menaxhmentit me dt: 11.02.2022.
- Vendimi për emërim të Ushtrueses të Detyrës së Zyrtares Kryesore Financiare me dt.11.02.2022
- Aprovimi i raportit vjetor të Auditimit për vitin 2021 me dt: 29.04.2022
- Aprovimet e raporteve të KE-së, ZKF-së dhe Sekretares për tremujorin e parë të 2022 me dt. 29.04.2022
- Vendim për hapjen e konkursit për Kryeshef Ekzekutiv me dt:17.06.2022
- Vendimi për zgjidhjen e kryesuesit të Bordit të Drejtoreve me dt : 08.06.2022
- Vendimi për zgjidhjen e kryesuesit të Komisionit të Auditim me dt: 08.06.2022
- Aprovimet e raporteve të KE-së, ZKF-së dhe Sekretares për tremujorin e dytë të 2022 me dt. 22.07.2022
- Vendimi për nisjen e procedurave për tenderin e furnizimit me Biomase me dt: 05.09.2022
- Shqyrtimi dhe aprovimi i raportit të auditorit të jashtëm me dt. 28.05.2022.
- Aprovimet e raporteve të KE-së, ZKF-së dhe Sekretares për tremujorin e tretë të 2022 me dt. 14.10.2022
- Aprovimi i raportit për Komisionin Komunal të Aksionarit për vitin 2021 me dt. 18.10.2022.
- Vendimi për caktimin e U.D të Kryeshefit Ekzekutiv me dt: 14.12.2022
- Vendimi për caktimin e U.D. të Sekretares/ Këshilltares të Përgjithshme me dt: 14.12.2022
- Aprovimi i planit të biznesit me dt.25.11.2022.

1.4. Raportimi nga Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv

Fillimi i vitit 2022 e ka gjetur ndërmarrjen në operim të rregullt dhe krahasuar me vitet tjera në një pozitë shumë të volitshme sa u përket çështjeve teknike, ndërsa kemi vazhduar të përballemi me jo stabilitet financiar. Përkrahja e ofruar tash e sa vite me radhë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, e cila përmes subvencioneve të rregullta ka vazhduar të mbulojë shpenzimet e lëndës djegëse, ka mundësuar vazhdimin e operimit dhe ofrimin e shërbimeve për konsumatorët tanë me një kosto të ulët.

Viti 2022 ka qenë mjaft sfidues sa i përket furnizimit me lëndë djegëse. Duke filluar nga sezoni e kaluar kur sasia e kontratës së parë është shpenzuar në fund të janarit, ashtu që jemi detyruar të hapim procedurat e shpejta të tenderimit që të mund të vazhdojmë sezonin. Në këtë vazhdë janë

shpenzuar mjetet e ndara nga Ministria e Ekonomisë edhe për vitin 2022. Menjëherë pas përfundimit të sezonit 2021/2022 i jemi drejtuar ME-së duke e njoftuar edhe MF dhe KK se për tu përgatitur për sezonin 2022/2023 na duhen mjete shtesë për blerjen e lëndës djegëse. Në këtë periudhë ka qenë mjaft sfiduese jo vetëm çështja e mjeteve por edhe disponueshmërisë së lëndës djegëse për shkak të fillimit të luftës në Ukrainë dhe rrjedhimisht edhe krizës së përgjithshme të shkaktuar, e posaçërisht ajo energjetike. Si rrjedhojë e kërkesave të vazhdueshme nga muaji Mars duke vazhduar edhe në muajt në vijim pas shumë përpjekjeve me dt.31.08.2022 kemi pranuar konfirmim me shkrim nga ME të aprovimit të mjeteve shtesë dhe menjëherë edhe pse shumë me vonesë kemi filluar procesin e prokurimit. Ku në fillim të Tetorit është nënshkruar edhe kontrata e furnizimit me lëndë të parë. Dhe sezoni ka filluar në Nëntor 2022.

Ndërkohë kemi qenë në komunikim të vazhdueshëm me ZRRE-në sa i përket aplikimit për tarifa të ngrohjes e cila edhe këtë vit ka qenë me M2. Përkundër kërkesës për rritje të tarifave, vendimi i ZRRE-së është që të vazhdohet me tarifa të njëjta edhe këtë vit, që nuk ka qenë i favorshëm për ndërmarrjen sepse tarifat e tilla nuk e mundësojnë në asnjë mënyrë pavarësinë financiare të ndërmarrjes, sidomos kur kemi parasysh që çmimi i lëndës djegëse është dyfishuar këtë vit për shkak të krizës.

Një gjë shumë pozitive e cila është evidente gjatë viteve të fundit, e rrjedhimisht edhe në vitin 2022, është shkalla e inkasimeve e cila vazhdon të mbetet në nivel të lartë. Kjo çështje e cila për shumë ndërmarrje publike në Kosovë, ndonëse deri para 7 viteve edhe për Ngrohoren e Qytetit në Gjakovë ka qenë pengesë evidente në afarizmin e ndërmarrjes, tashmë është stabilizuar pothuajse tërësisht.

Po ashtu është vazhduar me punimet e projektit “Përmirësimin e performancës së Ngrohtores së Qytetit në Gjakovë” – financuar nga SECO Zvicëranë dhe KK Gjakovë. Në vlerën e përgjithshme të këtij projekti, SECO merr pjesë me 5.3 milionë €, ndërsa 0.5 milionë nga Komuna e Gjakovës. Përfutjes të këtij projekti është Ngrohitorja e Qytetit Gjakovë dhe Spitali Rajonal i Gjakovës.

Ky projekt përbëhet nga 4 komponentë:

1. Zhvillimi i Korporatës-në vazhdim e sipër. Është mbajtur një sesion informues në muajin Prill , ashtu që janë njoftuar konsumatorët me detajet e këtij projekti. Janë përpiluar 14 rregullore të ndërmarrjes ku 10 prej tyre janë aprovuar nga BD-ve ne tetor te vitin 2022 me date 27.10.2022.
2. Përmirësimi i eficiencës së energjisë në rrjetin e NQ-së - kjo komponent ka përfunduar në kuadër të të cilës janë rehabilitimi i rrjetit dhe nënstacioneve si dhe vendosja e orëmatësve. Ndërrimi i gypave në pjesën veriore të rrjetit ka bërë që gjatë operimit me pjesën veriore të kemi zero humbje të ujit.

3. Avancimi i rrjetit të ngrohjes së Spitalit - ka filluar në muajin Gusht dhe është në vazhdim e sipër, ndërsa ngrohja ka filluar në ndërtesën kryesore të Spitalit në fillim të Dhjetorit dhe po funksionon si asnjëherë më parë.
4. Lidhja e ndërtesave tjera publike - ka përfunduar edhe kjo komponentë dhe shumica nga ndërtesat e reja të lidhura po ngrohen nga Ngrohtorja e Qytetit.

Është nënshkruar marrëveshje me K.R.M Çabratin për shërbime të ndryshme, në kuadër të së cilës hyn edhe shërbimi për bartjen e degëve nga Pashtriku të cilat janë prerë dhe pastruar përmes projektit të financuar nga GIZ.

1.5. Historiku

Ndërmarrja Publike "Ngrohtorja e Qytetit" në Gjakovë është themeluar në vitin 1981 dhe nga Janari i vitit 2008 është shndërruar në shoqëri aksionare. Me miratimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nga Kuvendi i Kosovës në qershor të 2008 pronare e plotë e kësaj ndërmarrje është Komuna e Gjakovës me 100% të aksioneve.


Ndërmarrja ofron shërbimet e ngrohjes duke operuar në sektorin publik, komercial dhe atë të amvisërisë në territorin e qytetit të Gjakovës. Ndërmarrja funksionon në bazë të ligjeve në fuqi, akteve nënligjore, akteve tjera normative dhe standardeve të kontabilitetit.

1.6. Informatat e përgjithshme

Ndërmarrja Publike Lokale "Ngrohtorja e Qytetit" SH.A. në Gjakovë është Shoqëri Aksionare, me numër të regjistrimit të biznesit: 811326471, me adresë në Gjakovë, rruga "Behije Dashi" pn. 50000 Gjakovë. Organizimi i ndërmarrjes është i strukturuar ku sipas hierarkisë përfshihen Bordi i Drejtorëve dhe Kryeshefi Ekzekutiv kurse në kuadër të strukturës së brendshme janë gjithsej katër shërbime:

- Shërbimi Financiar,
- Shërbimi i Prodhimit
- Shërbimi i Shpërndarjes dhe Furnizimit
- Shërbimi Administrativo-Juridik

Figure 1. Organogrami i Ndërmarrjes -



Veprimtaria e ndërmarrjes e licencuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) përfshinë:

- Prodhimin e energjisë termike,
- Shpërndarjen e energjisë termike dhe
- Furnizimin e konsumatorëve me energji termike
- Prodhimi i energjisë elektrike;

Prodhimi i energjisë termike bëhet me kapacitetet e reja për prodhimin e energjisë termike (ngrohjes) dhe bashkëprodhimin e energjisë elektrike dhe termike do të mundësojnë prodhim të mjaftueshëm për një furnizim cilësor të konsumatorëve.

Kapacitetet prodhuese aktuale me impiantin e ri janë:

- Njësitë (kaldajat) për prodhim të energjisë termike me kapacitet nominal 2 x 5.5MWTH;
- Njësia e ko-gjenerimit të energjisë elektrike dhe asaj termike me kapacitetet 1.2MWEL dhe 4WTH;

Pra gjithsejtë kapacitetit i prodhimit të ngrohjes (energjisë termike) 15 MWTH dhe Kapaciteti e prodhimit të energjisë elektrike 1.2 MWEL

Shpërndarja e energjisë termike bëhet përmes rrjetit të termofikimit i cili përfshin të ashtuquajturin rrjetin primar dhe shtrihet në dy pjesë duke u nisur nga njësia e prodhimit të energjisë termike. Pjesa e vjetër e rrjetit e cila shtrihet nga Ngrohitorja e Qytetit, shkon në drejtim të pjesës veriore të Qytetit dhe arrin deri te shkolla fillore Zekeria Rexha. Në këtë pjesë të rrjetit të vendosur në vitin 1980, janë të kyçur kryesisht Institucione, si: Shkolla, shtëpi të shëndetit, Kuvendi Komunal, Pallati i Kulturës si dhe ndërtesa kolektive. Kjo pjesë e rrjetit përbën një gjatësi të trasesë prej 5.6 km e cila i përfshin dy gypa te ujit. Këta gypa janë gypa të zi të izoluar me lesh mineral dhe i mbështjellë me ter letër të vendosur në kanal të betonit.

Pjesa e re e rrjetit, e vendosur nga Ngrohitorja e Qytetit, shkon në drejtim të pjesës jugore të Qytetit duke arritur deri te Spitali rajonal Isa Grezda, i cili gjithashtu furnizohet me ngrohje. Kjo pjesë e rrjetit ka qenë donacion i SIDA-s organizatë Suedeze e vendosur në vitin 2001 dhe qëllimi kryesorë ka qenë të mundësoje kyçjen e Spitalit në rrjetin primar të termofikimit. Pjesa jugore e rrjetit përfshin një gjatësi prej 16.6 km trase në të cilën janë të vendosur dy gypa të para izoluar. Në këtë pjesë të rrjetit kemi një kombinim pak më ndryshe të konsumatorëve të kyçur në rrjet, krahasuar me pjesën veriore të rrjetit. Karakteristikë e kësaj pjese të rrjetit është se përveç institucioneve dhe disa ndërtesave kolektive, strukturën e konsumatorëve sipas numrit të tyre e dominojnë shtëpitë individuale, të cilat edhe sot përbëjnë një pjesë shumë të vlefshme të konsumatorëve tanë.

Furnizimi i konsumatorëve me energji termike bëhet përmes këmbyesve të energjisë të cilët janë të vendosur në nënstacione dhe bëjnë kalimin e energjisë nga rrjeti primar në rrjetin sekondar. Rrjeti sekondar është pjesë e konsumatorëve dhe rrjedhimisht Ngrohtorja e Qytetit është përgjegjëse për distribuimin e energjisë deri te këmbyesi.



Figura 1. Rrjeti primar i sjellësit të ujit të ngrrohtë

1.7. Aktivitetet dhe performanca e ndërmarrjes

Në këtë pjesë të raportit do të pasqyrohen të dhënat për performancën e ndërmarrjes si dhe sfidat më të cilat jemi ballafaquar gjatë vitit 2022. Aktivitetet kryesore të ndërmarrjes kanë qenë në realizimin e objektivave të planifikuara për vitin 2022 si dhe angazhimi në tejkalimin e pengesave dhe vështirësive tjera nga aktivitetet kryesore të ndërmarrja.

1.8. Sektori i Financave dhe Thesarit

Raportet financiare prezantojnë në mënyrë të përgjithësuar të gjitha aktivitetet e zhvilluara nga Ndërmarrja, sa janë realizuar ato duke i prezantuar përmes tabelave si dhe duke dhënë sqarime me detale.

Gjendja e rënduar financiare, e krijuar nga periudhat e mëhershme, si dhe çmimi gjithnjë e më i lartë i lëndës djegëse ka bërë që ndërmarrja gjatë viteve të fundit të operoj vetëm 115 ditë. Gjatë vitit 2022 sezoni 2021/2022 ka përfunduar me 10 Mars 2022, ndërsa operimi për sezonin 2022/2023 ka filluar me 07.11.2022 dhe ka vazhduar deri me 01.03.2023. Deri në fund të vitit gjithçka ka shkuar mirë nga ana e prodhimit të ngrohjes termike. Por sfidë kanë qenë humbjet e ujit në rrjet, të cilat kur është lëshuar pjesa jugore e qytetit kanë qenë të konsiderueshme. Pas gjetjes së shpërthimeve të cilat kanë shkaktuar këto humbje janë sanuar nga departamenti përkatës. Nga këto humbje mund të themi se rrjeti i pjesës jugore ka nevojë për investime të konsiderueshme ashtu që të mund të kemi humbje minimale, të cilat rrjedhimisht e kursejnë në masë të madhe edhe shpenzimin e lëndës djegëse.

Çmimi të cilin e paguajnë konsumatorët tanë kundrejt shërbimeve të ofruara nga Ngrohtorja e Qytetit, llogaritet duke u bazuar në tarifat të cilat përcaktohen paraprakisht nga Zyra e Rregullatorit për Energji. Këto tarifa përcaktohen duke u bazuar në shumë faktorë, duke shfrytëzuar një metodologji të caktuar.

Përcaktimi i tarifave bëhet para çdo sezoni të ngrohjes. Përkundër kërkesës për rritje të tarifave, vendimi i ZRRE-së ka qenë që të vazhdohet me tarifa të njëjta edhe këtë vit, që nuk ka qenë i favorshëm për ndërmarrjen sepse tarifat e tilla nuk e mundësojnë në asnjë mënyrë pavarësinë financiare të ndërmarrjes, sidomos kur kemi parasysh që çmimi i lëndës djegëse është dyfishuar këtë vit për shkak të krizës.

Meqë ka mbetur pa u marrë leja mjedisore për licencë të prodhimit të energjisë elektrike, është bërë aplikimi i lejes mjedisore por procesi ka mbetur i papërfunduar për shkak se kompania EGIS prej të cilës janë pritur angazhimet e ekspertëve për procesin e fillimit të punës së turbinës, nuk kanë arritur të sigurojnë një eksperte të mirëfilltë.

Më poshtë janë të paraqitura tarifat për sezonin ngrohës të vitit 2021/2022:

Tabelë 1. Tarifa për konsumatorët që faturohen sipas sipërfaqes në m²

Komponentët e tarifave	Konsumatorët shtëpiakë	Konsumatorët komercialë e institucionalë
Tarifa për kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes (komponentë fikse)	0.09 [€/m ² për muaj]	0.13 [€/m ² për muaj]
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponentë variabël)	0.81 (€/m ² për muaj)	1.16 (€/m ² për muaj)
TOTALI	0.90 (€/m ² për muaj)	1.29 (€/m ² për muaj)

Tabelë 2. Tarifa për konsumatorët me matje (njehsor)

Tarifa për kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes (komponentë fikse)	0.85 (€/kë për muaj)
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponentë variabël)	54.65 (€/MWh)

Në lidhje me faturimin fillimisht duhet përmendur se edhe në sezonin 2021/2022 si dhe fillimi i sezonit 2022/2023, faturimi i konsumatorëve të energjisë termike është bazuar në sipërfaqen e ngrohjes për metër katror.

Më poshtë gjeni tabelën:

- Bilancin të Gjendjes për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 (Tabela 3)
- Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2022(Tabela4)
- Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2022 (Tabela 5)
- Pasqyra e rrjedhjes së parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2022 (Tabelë 6)

Tabelë 3. Bilanci i Gjendjes

"Ngrohtorja e Qytetit" SH.A.			
Pasqyra e pozitës financiare me 31 Dhjetor 2022			
	Shënimi	2021	2022
		€	€
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	9	415 200	174 560
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	6	172 864	198 489
Stoqet	7	192 967	294 436
Instrumentet financiare derivative			
Pasuritë financiare sipas vlerës së drejtë			
Pasuritë e klasifikuara si të mbajtura për shitje			
Pasuritë e tjera afatshkurtra	8	152 174	194 695
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		933 205	862 180
Pasuritë afatgjata			
Prona, pajisjet dhe impiantet	5	14 159 849	15 993 140
Investimet e mbajtura deri në maturim			
Pasuritë financiare të mbajtura për shitje			
Investimet e trajtuara sipas metodës së ekuitetit			
Prona investuese			
Investimet në vijim			
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë e shtyra tatimore			
Pasuritë e tjera afatgjata			
Gjithsej pasuritë afatgjata		14 159 849	15 993 140
Gjithsej pasuritë		15 093 054	16 855 320
DETYRIMET DHE EKUITETI			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	12	158 216	272 914
Kreditë dhe huatë, pjesa afatshkurtër			
Tatimet e pagueshme aktuale			
Të hyrat e shtyra	11	752 973	225 870
Provizionet afatshkurta			
Përfitimet e punonjësve të pagueshme			
Detyrimet ndaj lizingut, pjesa afatshkurtër			

Detyrimet e tjera afatshkurtra	13	46 530	61 832
Detyrimet kontigjente			
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		957 719	560 616
Detyrimet afatgjata			
Kreditë dhe huatë, pjesa afatgjatë			
Provizionet afatgjata			
Të hyrat e shtyera, pjesa afatgjatë	11	13 538 096	15 717 935
Detyrimet e shtyra tatimore			
Përfitimet e punonjësve të pagueshme			
Detyrimet e tjera afatgjata			
Gjithsej detyrimet afatgjata		14 188 881	15 717 935
Gjithsej detyrimet		14 495 816	16 278 551
EKUITETI			
Kapitali aksionar	10	2 143 322	2 143 322
Fitimet e mbajtura		(1 546 083)	(1 566 553)
Rezervat e tjera			
Gjithsej ekuiteti		597 239	576 769
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		15 093 054	16 855 320

Tabelë 4. Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2022

	Shënimi	2021	2022
		€	€
Të hyrat	14	886 316	1 963 184
Kostoja e shitjes	15	(223 875)	(808 516)
Fitimi / (humbja) bruto		662 441	1 154 668
Të ardhurat tjera			
Shpenzimet e shpërndarjes	17	(466 047)	(890 555)
Shpenzimet administrative	16	(333 493)	(284 582)
Fitimet/humbjet tjera – neto			-
Fitimi / (humbja) operativ		(137 099)	(20 469)
Shpenzimet financiare		0	0
Të ardhurat financiare		0	0
Fitimi / (humbja) para tatimit		(137 099)	(20 469)
Shpenzimet e tatimit në fitim		0	0
Fitimi / (humbja) i/e vitit		(137 099)	(20 469)
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:			

Diferencat këmbimore nga përkthimi i PF të operacioneve të huaja, neto nga tatimi			
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse të vitit			
Gjithsej të ardhurat / (humbjet) gjithëpërfshirëse të vitit		(137 099)	(20 469)

Tabelë 5. Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2022

	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Rezervat e tjera	Gjithsej
	€	€	€	€
Gjendja më 1 janar 2021	2 143 322	(1 408 984)	-	734 338
Fitimi / (humbja) i/e vitit	-	(137 099)	-	(137 099)
Diferencat nga përkthimet valutore				
Dividendat				
Deponimet e kapitalit shtesë				
Ndarja e rezervave		0	0	
Gjendja më 31 dhjetor 2021	2 143 322	(1 546 083)		597 239
Fitimi / (humbja) i/e vitit		(20 469)		(20 469)
Diferencat nga përkthimet valutore				
Dividendat				
Deponimet e kapitalit shtesë				
Ndarja e rezervave				
Gjendja më 31 dhjetor 2022	2 143 322	(1 566 552)	0	576 770

Tabelë 6. Pasqyra e rrjedhjes së parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2022

	Shënimi	2021	2022
		€	€
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		328 948	870 086
Fitimi / (humbja) i / e vitit		(137 099)	(20 469)
Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave			
Zhvierësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	5	466 047	890 555
Dëmtimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve			
Amortizimi i pasurive të paprekshme			
Humbjet nga dëmtimi në pasuritë e paprekshme			
Ndryshimi i vlerës së pronës investuese			
Të ardhurat financiare			
Shpenzimet financiare			
(Fitimi) / humbja nga shitja e pronës, fabrikës dhe pajisjeve			
Shpenzimet e tatimit në fitim			
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative			
(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	6	(55 391)	(25 626)
(Rritja) / zvogëlimi në stoke	7	(34 548)	(101 470)
(Rritja) / zvogëlimi në pasuritë e tjera	8	(132 223)	(42 521)
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	12	20 916	114 698
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera	13	(17 609)	15 306
Rritja/Zvogëlimi në të hyrat e shtyra	11	13 519 983	1 652 736
Tatimi në fitim i paguar			
Interesi i paguar			
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative		13 630 075	2 483 205
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	5	(13 449 545)	(2 723 845)
Arkëtimet për shitjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve			
Pagesat për blerjet e pasurive të paprekshme			
Arkëtimet për shitjen e pasurive të paprekshme			
Interesi i arkëtuar			

Dividendat e arkëtuara			
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese		(13 449 545)	(2 723 845)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Deponimet e kapitalit shtesë			
Dividendat e paguara			
Arkëtimet nga kreditë dhe huatë			
Ri pagimi i kredive dhe huave			
Pagesat e lizingut financiar			
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese			
Rritja / (zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë		180 530	(240 640)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	9	234 671	415,200
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit		415 200	174 560

1.9. Sektori i faturimit dhe inkasimit


Edhe pse kërkesat për ofrim të shërbimit për klientët kanë qenë të mëdha, janë konsideruar vetëm ata të cilët kanë qenë të përshtatshëm në aspektin e afërsisë së rrjetit, duke pas kujdes që këto kycje të mos dëmtojnë kualitetin e ngrohjes për klientët ekzistues.

Në tabelën e mëposhtme janë të dhënat për numrin e klientëve të cilët kanë marrë shërbim nga Ngrohitorja e Qytetit duke filluar nga Janar i 2022.

➤ Klientët

Tabelë 7. Konsumatorët aktiv

2021	Numri i klientëve	2022	Numri i klientëve
Janar 2021	419	Janar 2022	496
Tetor 2021	360	Shkurt 2022	445
Nëntor 2021	446	Mars 2022	438
Dhjetor 2021	501	Nëntor 2022	533
		Dhjetor 2022	583



➤ **Faturimi**

Faturimin për vitin 2022 përfshin periudhën prej 01.01.2022-31.12.2022. Gjatë kësaj periudhe është operuar gjatë muajve.

1. Janar - 01.01.2022-31.01.2022 në vlerë prej **92.160.16**
2. Shkurt-01.02.2022-28.02.2022 në vlerë prej **75,872.93**
3. Mars – Pjesërisht (01.03.2022-10.03.2022) në vlerë prej **26,704.83**
4. Nëntor-Pjesërisht (07.11.2022-30.11.2022) në vlerë prej **58,235.62**
5. Dhjetor-01.12.2022-31.12.2022 në vlerë prej **127,085.55**

Në tabelën në vijim i gjeni të dhënat e faturimit për vitin 2022 si dhe krahasimin me vitin paraprak, të ndara sipas grupimeve të klientëve.

Tabelë 8. Tabela e të Hyrave

	Sipas grupimit	2022	2021
Amvisëria	Banesat	59,387.96	43,281.13
	Shtëpitë	69,795.26	48,968.97
	Kyçjet e reja	6,962.87	2,665.00
	Total	135,060.61	94,915.10
Bizneset	Shëndetësia	68,912.52	54,193.55
	Shkollat	104,913.27	55,878.15
	Institucionet publike, komerciale dhe shtetënore	59,420.28	39,499.94
	Lokalet	14,487.43	10,011.71
	Total	247,733.5	159,583.35
	Grand Total	382,794.11	254,498.45

➤ **Shpenzimet**

Shpenzimet për vitin 2022 po ju paraqesim në tabelën e mëposhtme:

Tabelë 9. Tabela e shpenzimeve

Lloji i shpenzimit	2022	2021
Energjia elektrike	33,883.17	41,384.57
Ujë	15,844.81	16,296.12
Telefon	1,588.69	1,459.09
Tjerat	31,843.87	172,202.17
Total	83,160.54	231,341.95
Shpenzimet për biomasë	1,077,084.27	302,366.40
Shpenzimet e ADETEX (vendosja e njehsorëve)	301,269.40	-
Total	1,461,514.21	533,708.35
Shpenzimet e pagave	202,137.11	191,776.29
GRAND TOTAL	1,663,651.32	725,484.64

Shpenzime te tjera:

Lloji i shpenzimit	2022
Shpenzimet e auditimit	1,298.00
Zyra e Rregullatorit për Energji	1,247.30
Leje Mjedisore	660.00
Shpenzimet e mbeturinave	1,432.20
Shpenzimet për trajtim te ujit	864.0
Shpenzimet për krip	5,400.00
Shpenzimet e servisimit te kompresorëve te ajrit	971.68
Shpenzimet e servisimit te aparateve kundër zjarrit	990
Shpenzimet e servisimit te bagerit	794.77
Testimi dhe kalibrimi I peshores	520.00
Sigurimi dhe monitorimi I kamerave	1,149.00
Dezinfektimi I objektit	997.50
Mirëmbajtja vjetore e programit	897,84
Shpenzimet e internetit	635.00
Shpenzimet e kuvendit komunal	4,233.73
Derivate	4,530.78
Shpenzimet e konkurseve	250.00
Lende përmbarimore	173.46
Shpenzimet e automjeteve	389.20
Shpenzimet e prodhimit	615.51
Shpenzimet e taksave te ndryshme	132.37
Shpenzimet e provizioneve	615.51
Shpenzimet e udhëtimit	600.00
Mirëmbajtja vjetore e webfaqes	175.00
Shpenzimet e reprezentacionit	1,573.80
Shpenzimet tjera	872.60
	31,843.87

1.10. Sektori i prokurimit

Në periudhën Janar – Dhjetor 2022, bazuar në planin e prokurimit të aprovuar në fund të vitit 2021, janë zhvilluar procedurat e prokurimit si në tabelën e mëposhtme:

Tabelë 10. Aktivitetet e prokurimit

Nr.	Përshkrimi	OE fitues	Vlera e kontratës
1	Furnizimi me tableta Kripë NACL	NTP"Euroni"	900.00
2	Furnizim me gdhendla druri-Biomasë	Feniks-A SHPK	194,600.00
3	Furnizimi me tableta Kripë NACL	NTP"Euroni	9,000.00
4	Shërbim Transporti për Punëtori	Kushtimi NMI	650.00
5	Servisimi i Aparateve kundër Zjarrit	Tekniku SHPK	990.00
6	Sigurimi fizik i objektit	Kingdom Security	989.00
7	Deratizimi, Dezinfektimi dhe Dezinsektimi	Truly Nolen SHPK	900.00
8	Furnizim me gdhendla druri-Biomasë	Feniks-A SHPK	750,000.00
9	Kalibrimi dhe testimi i peshorës	Vëllezërit Mustafa SHPK	800.00
10	Furnizim me testomat	Profitech SHPK	999.00
11	Servisim i Bagerit me Lugë-Liebherr-L58	Ortu SHPK	800.00
12	Servisim i Kompresorit të ajrit -Kaeser SX 8T	Euro Sëiss SHPK	900.00
13	Auditim i Jashtëm për vitin 2022	Quatra Audit LLC	1,500.00
14	Furnizim me rroba pune	Filli Tex SHPK	750.00
		Total:	963,778.00

➤ **Blerja e lëndës së parë**

Blerjet e biomasës janë shpenzimi kryesor, por këto blerje janë bërë me mjetet e ndara nga subvencioni për vitin 2022, të cilat ishin në vlerë prej 300,000.00 €. Po ashtu kemi pranuar mjete shtesë të subvencionit nga ME sipas aneks 1 e marrëveshjes së datës 12.09.2022 në vlerë prej 350,000 € dhe ankes 2 e marrëveshjes së datës 16.12.2022 në vlerë prej 253,922.63€. Në vazhdim po paraqesim tabelën me detajet e liferimit të mjeteve në NLB banka : Ndërsa fatura të pranura për blerjen e biomasës për vitin 2022 janë gjithsej 269 në vlerë prej 1,077,84.27€. Gjithsejtë vlera e pagesave për vitin 2022 është 956,488.55 €.

DATA	VLERA
08.02.2022	100,283.24 €
04.03.2022	31,542.33 €
25.03.2022	89,171.05 €
30.08.2022	79,003.38 €
28.10.2022	39,278.91 €
04.11.2022	66,777.55€
17.11.2022	66,119.54 €
05.12.2022	66,427.66 €
19.12.2022	111,396.33 €
27.12.2022	253,922.42 €
TOTALI:	903,922.41 €

Gjendja fillestare	Faturat e pranura 2022	Pagesat me subvencion 2022	Pagesat nga Ngrohitorja	Pagesat tjera	Gjendja përfundimtare
0.00	956,488.55 €	903,922.41 €	52,566.14 €	0.00	120,595.72

Vlerat e paraqitura në tabelën më poshtë janë të paguara nga të hyrat vetanake:

DATA	VLERA	BANKA
04.02.2022	21,069.64 €	RBKO
22.04.2022	25,000.00 €	RBKO
30.08.2022	996.50 €	NLB
27.12.2022	5500.00€	RBKO

1.11. Sektori Juridik/Administrativ

Shërbimi i përgjithshëm administrativ-juridik në NP "Ngrohtorja e Qytetit" SH.A. Gjakovë gjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022 ka kryer këto aktivitete:

- Asistimi dhe mbarëvajtja e mbledhjeve të BD-ve dhe Komisionit të Auditimit.
- Vendime / Vendime për pushime vjetor.
- Bashkëpunimi me Gjykatën Themelore në Gjakovë.
- Bashkëpunimi me Përmbarues Privat në Gjakovë.
- Konkursat e shpallura.
- Përzgjedhja e Bordit të ri të Drejtorëve.
- Kontratat për themelimin e marrëdhënies së punës.
- Kontrata për punë dhe detyra specifike.
- Ndërprerja e kontratës me kohë të Pacaktuar dhe të caktuar.
- Deklarimi i pasurisë
- Statuti i ri i ndërmarrjes
- Kërkesa për shpalljen e Tenderëve.
- Inspektorati i punës Gjakovë dhe Prishtinë.
- Raportet 3 mujore/ vjetore tek Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës - ARPL .
- Raportet 3 mujore/ vjetore tek Zyra e Rregullatorit për Energji.
- Përgatitja e dokumenteve zyrtare si: Kërkesave, Njoftimeve, Vërejtjeve, Vendime të BD-ve, vendime të ndryshme si dhe punë të tjera për nevojat e ndryshme të kësaj ndërmarrje.

Gjatë kësaj periudhe kohore Janar – Dhjetor 2022 janë mbajtur 7 (shtatë) mbledhje të rregullta të Bordit të Drejtorëve dhe 1 (një) mbledhje e jashtëzakonshme, si dhe 5 mbledhje të Komisionit të Auditimit.

1.12. Burimet njerëzore

Ndërmarrja ka pasur gjatë 2022 të punësuar gjithsej 34 punonjës. Përgatitja e punëtorëve sipas kualifikimit të tyre është: Master 20 %, Fakultet 10%, Shkollë të lartë 3% dhe shkollë të mesme 67%.

Tabelë 11. Kualifikimi i punëtorëve

Numri i përgjithshëm i punëtorëve	Meshkuj	Femra	Totali
Magjistër/ Master	3	4	7
Fakultet	0	3	3
Shkollë e lartë	0	1	1
Shkollë e mesme	23	0	23
Totali	26	8	34

1.13. Aktivitetet e Auditimit të Brendshëm

Gjatë vitit 2022 janë mbajtur 5 mbledhje të Komisionit të Auditimit. Gjatë kësaj periudhe janë prezantuar nga auditori i brendshëm raportet e përgatitura në bazë të planit vjetor dhe sipas kërkesës së Komisionit të Auditimit. Po ashtu është mbajtur edhe mbledhja e KA-së për shqyrtimin dhe aprovimin e PF. Fillimisht duhet të theksohet se të gjitha aktivitetet e ndërmarra gjatë kësaj periudhe raportuese, e që kanë të bëjnë me fushën e auditimit, janë zhvilluar në pajtim me planin vjetor të punës së auditorit të brendshëm për vitin 2022. Gjatë vitit 2022 janë kryer auditimet sipas Planit Vjetor dhe me kërkesë nga Komisioni i Auditimit, dhe janë prezantuar para Komisionit të Auditimit.

Më poshtë janë të paraqitura shkurtimisht pikat e planit vjetor dhe raportet në periudha gjatë vitit 2022:

Tabela 12 . Planifikimit vjetor i Auditimit të Brendshëm

Njësitë për t'u audituar/ Detyrat	Periudha e auditimit	Raporti final
Financat	Janar-Mars 2022	Prill 2022
Shërbimi Juridik dhe Administrata	Prill-Qershor 2022	Korrik 2022
Prokurimi	Korrik-Shtator 2022	Tetor 2022
Plani vjetor i auditimit për vitin 2023	Tetor 2022	Tetor 2022
Shërbimi i Prodhimit dhe Shpërndarjes	Tetor-Dhjetor 2022	Janar 2023

Në bazë të planit vjetor të punës së auditorit të brendshëm, janë realizuar auditime të proceseve në subjekte brenda kompanisë. Subjekte të auditimit kanë qenë pothuajse të gjitha departamentet dhe njësitë që funksionojnë në kuadër të ndërmarrjes.

Sa i përket auditimeve, pas përfundimit të tyre, në pajtim me procedurat dhe standardet e auditimit të brendshëm është bërë: përgatitja e draft raporteve dhe raporteve finale për secilin auditim, mbajtja e takimeve me udhëheqësit e subjekteve të audituara, si dhe diskutimi i të gjeturave dhe rekomandimeve si dhe aprovimi i tyre nga Komisioni i Auditimit.

1.14. Synimet e ndërmarrjes

N.P. "Ngrohtorja e Qytetit" SH. A. ka për synim furnizimin e konsumatorëve me ngrohje sa më cilësore, shërbime të efektshme me përkujdesje si dhe arritja deri te finalizimi i projektit. T'u ofrojmë konsumatorëve shërbime të mira dhe të vazhdojmë të mbajmë nivelin e deritashëm të pagesës së faturave, t'u mundësojmë punëtorëve tanë zhvillim personal dhe karrierë të kënaqshme, t'i bindim donatorët që investimet e tyre do të jenë të shpagueshme. Në kuadër të angazhimeve të gjithmbarshme për vazhdimin e aktivitetit të ndërmarrjes përgjatë vitit 2023 N.P. 'Ngrohtorja e Qytetit' SH.A. në Gjakovë ka parashtruar këto qëllime:

1. Ngritja e kapaciteteve të stafit,
2. Sigurimi i të hyrave të përgjithshme,
3. Sistematizimi i punonjësve në vendet e reja të punës,
4. Bashkërendimi i veprimeve për lëndën djegëse të re (biomasë).




Figura 1. Pamja 3D e objektit të Ngrohtores së Re

N.P. 'Ngrohtorja e Qytetit' SH.A. në Gjakovë kryesisht e ka të kompletuar stafin e administratës dhe udhëheqësit e shërbimeve që janë të gatshëm për tu përballë me sfidat e ndërrimit të teknologjisë me fillimin e implementimit të projektit të kogjenerimit. Moshë e shtyre e disa punonjësve të prodhimit duke pas parasysh ndryshimin e teknologjisë, paraqet pengesë në adaptimin e tyre për punë me teknologjinë e re. Andaj duhet të plotësohet me njerëz tjerë të rinj për tu angazhuar në punë me teknologjinë e re. Në kuadër të komponentës Nr.1 të projektit në implementim duhet parë në kuadër të punonjësve aktual edhe mundësitë e sistematizimit.


Përgjithësisht, synimet kryesore për vitin 2023 mund të përmbliken sikurse më poshtë:

2. Trajnimet janë paraparë nga fondet e siguruara nga SECO andaj në këtë drejtim priten veprimet dhe janë planifikuar për vitin 2023.
3. Sigurimi i të hyrave të përgjithshme nga inkasimi i sezonit dhe borxheve të vjetra në përputhje me marrëveshjet e nënshkruara sipas Ligjit për faljen e borxheve si dhe mbajtja e shpenzimeve operative në nivelin e tanishëm që mundëson rritjen e qëndrueshmërisë financiare të ndërmarrjes prandaj në kuadër të objektivave kryesore për stabilitet financiar të ndërmarrjes nevojitet që të vazhdohet aktiviteti.
4. Në kuadër të kontakteve të vazhdueshme me akterët vendimmarrës, do të kërkohet që për të mbajtur vijimësinë e punës. ME të realizojë zotimet për vazhdimin me subvencione sikurse viteve paraprake kurse KK Gjakovë të realizojë pagesat.
5. Krijimi i zingjirit furnizues me biomasë ngelet sfida kryesore andaj nevojitet angazhim dhe koordinim me të gjithë akterët relevant nga niveli lokal dhe qendror.

1.15. Rekomandime


Bordi i Drejtoreve të NP "Ngrohtorja e Qytetit" Gjakova Sh. A. duke pasur parasysh sfidat dhe problemet që ballafaqohet Ndërmarrja për furnizim të lëndës së parë Biomase për të filluar sezonin e ngrohjes së konsumatorëve, rekomando menaxhmentin të ndërmerr masa paraprake për të evituar vonesat eventual në fillimin e sezonit të ngrohjes.

Anëtarët e Bordit të Përkohshëm të Drejtoreve :




Florent Koci

Kryesues i BD-ve



Burim Bajrami

Anëtar i BD-ve




Rina Domi

Anëtare e BD-ve



Gentiana Qurdina

Anëtare e BD-ve



U.D. i Kryeshefit Ekzekutiv

Arben Meka